



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 273

Tiranë – E premte, 3 mars 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 8885, datë 7.11.2016	Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotesojnë subjektet për transportin rrugor turistik..... 27719
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 8502, datë 24.10.2016	Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit..... 27724
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 70, datë 6.12.2016	Autorizim i ndihmës shtetërore me grante të drejtpërdrejta për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme..... 27726





## UDHËZIM

Nr. 8885, datë 7.11.2016

**PËR KUSHTET DHE KRITERET QË  
DUHET TË PLOTESOJNË SUBJEKTET  
PËR TRANSPORTIN RRUGOR TURISTIK**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, nenit 3, pika 3.11 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

## UDHËZOJNË:

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**
**Neni 1  
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik/të rastit të udhëtarëve brenda vendit dhe jashtë vendit.

**Neni 2  
Fusha e zbatimit**

Ky udhëzim do të zbatohet për subjektet e transportit (fizikë/juridik) rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe ndërkombëtar, për tretë ose me qira dhe për transportuesit për llogari të vet, të cilët përdorin mjete të regjistruara në Shqipëri dhe të destinuar për transportin rrugor turistik/të rastit të udhëtarëve:

a) me më shumë se nëntë persona përfshirë drejtuesin e mjetit, në veprimtarinë për tretë ose me qira;

b) me më shumë dhe/ ose nëntë persona përfshirë drejtuesin, në veprimtarinë për llogari të vet.

**Neni 3  
Përkufizime**

“Ligji për turizmin” është ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”;

“Ligji për transportet rrugore” është ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;

“Shërbime turistike/të rastit” janë shërbimet të cilat nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara, shërbimet vajtje-ardhje, sipas ligjit për transportet rrugore dhe ku karakteristika kryesore e të cilit është transporti i grupeve të udhëtarëve të krijuara më parë me iniciativë të të interesuarit ose të vetë transportuesit;

“Marrëveshja INTERBUS” është marrëveshja Europiane për transportin ndërkombëtar rrugor të rastit të udhëtarëve me autobus, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9305, datë 4.11.2004.

**KREU II  
KUSHTET DHE KRITERET**
**Neni 4  
Kushtet**

1. Shërbimet e turistike/të rastit të udhëtarëve kryhen vetëm nga subjektet e transportit që zotërojnë një licencë në shërbimet e rregullta, sipas këtij udhëzimi dhe kuadrit ligjor përkatës në fuqi dhe të pajisur me librin e udhëtimit, si dhe përcaktimet në dispozitat e VKM nr. 1101, datë 28.12.2015 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve”.

2. Shërbimet e rastit përfshijnë:

a) Udhëtimet “me dyer të mbyllura”, që janë shërbimet e kryera me të njëjtin autobus që transporton të njëjtin grup udhëtarësh të formuar më parë, duke i kthyer në vendin e nisjes;

b) Shërbimet që kryhen me udhëtimin e vajtjes plot dhe udhëtimin e kthimit bosh. Vendi i nisjes ndodhet në territorin ku transportuesi ka selinë.

c) Shërbimet në të cilat udhëtimi i vajtjes kryhet bosh dhe të gjithë udhëtarët merren në të njëjtin vend. Udhëtarët janë dërguar më parë, nga i njëjti operator transporti, me kushtet e shkronjës “b” më sipër, dhe transportohen në territorin e bashkisë ku operatori i transportit ka selinë;

Në shërbimet e rastit, nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit.

Përveç pajisjes me licencë dhe dokumentet e nevojshme të transportit, ndërmarrjet që kryejnë shërbime të rastit duhet të jenë të pajisur me një kontratë për çdo udhëtim me agjencitë udhëtimit/të transportit të licencuara.



Monitorimi i transportit turistik/të rastit, kryhet në vazhdimësi nga organet e kontrollit në rrugë në bashkëpunim me agjencitë e udhëtimit/të transportit.

#### Neni 5

### Kriteret për transportin rrugor turistik/të rastit brenda vendit

1. Të jetë i licencuar për transport udhëtarësh në shërbimet e rregullta, sipas legjislacionit për transportin rrugor.

2. Dokumenti (Policë sigurimi) se pronari/përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

i) sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;

ii) sigurimin e përgjegjesisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.

4. Aktin e vlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit për autobusin në transportin e udhëtarëve, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhëzimit nr. 1649 datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

5. Drejtuesi i mjetit, të jetë i pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP), në përputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, të ndryshuar.

6. Në rastin kur mjetet janë me qira, qiramarrësi është përgjegjës për:

a) operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira;

b) kryerjen e kontrolleve të duhura para përdorimit të mjetit dhe mirëmbajtjen e tij.

7. Kontrata e transportuesit /operatori turistik me agjencinë e udhëtimit/agjencinë e transportit.

#### Neni 6

### Kriteret për transportin rrugor turistik/të rastit ndërkombëtar

Transporti turistik/i rastit ndërkombëtar i udhëtarëve, kryhet me anën e librit të udhëtimit, në bazë të marrëveshjes INTERBUS, (për shtetet palë në këtë marrëveshje). Për shtetet e tjera ky shërbim kryhet në përputhje me marrëveshjet dypalëshe.

Për të kryer transportin rrugor turistik/të rastit ndërkombëtar, transportuesi/operatori turistik të jetë i:

a) licencuar për transport ndërkombëtar rrugor udhëtarësh sipas legjislacionit për licencat (ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 538, datë 2 6.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar).

b) i pajisur me librin e udhëtimit sipas marrëveshjes INTERBUS, e cila lëshohet nga ANALTIR (Shoqata për Transportin Ndërkombëtar të Udhëtarëve).

2. Dokumenti (Policë sigurimi) se pronari/përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

i) sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;

ii) sigurimin e përgjegjesisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

3. Certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar.

4. Aktin e vlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit për autobusin në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, lëshuar nga DPSHTRR, sipas udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar;

5. Drejtuesi i mjetit të jetë pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP), në përputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të



mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)", i ndryshuar.

6. Në rastin kur mjetet janë me qira, qiramarrësi është përgjegjës për:

a) operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira;

b) kryerjen e kontrolleve të duhura para përdorimit të mjetit dhe mirëmbajtjen e tij.

Një mjet i marrë me qira, që operon në shërbimet e rastit të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe përdoret për të njëjtin qëllim, nuk ndryshon fushën e operimit për të cilën ai është pajisur me certifikatë, dhe ai nuk pajiset me certifikatë të re, për pasojë, mjeti operon me certifikatën e lëshuar për subjektin transportues që e ka dhënë atë me qira.

Kontrata e transportuesit (operatori turistik) me agjencinë e udhëtimit/agjencinë e transportit.

#### Neni 7

### Detyrimet e subjektit transportues

1. Subjekti transportues i licencuar për kryerjen e transportit turistik/të rastit të udhëtarëve, do të marrë të gjitha masat për të garantuar kryerjen e këtij shërbimi dhe për plotësimin e kushteve dhe standardeve përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Nuk mund të organizohet transporti turistik/të rastit, në qoftë se nuk është lidhur një kontratë me një agjenci udhëtimi.

3. Subjekti transportues është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuar dhe t'i krijojë sa më shumë lehtësira për transportin e kësaj kategorie udhëtarësh. Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuar përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe/ose certifikatës së autobusit.

#### Neni 8

### Penalitetet

1. Në lidhje me kohën e drejtimit dhe periudhës së pushimit të drejtuesit të mjetit:

a) Tejkalon

i) maksimum 6 ditë pune ose prej një marzh 25% ose më shumë dhe

ii) gjatë periudhës ditore të punës, maksimumin e limitit të kohës ditore të drejtimit prej një marzhi 50% ose më shumë pa marrë një pushim/ndërprerje ose pa një periudhë pushimi pandërprerë të paktën 4,5 orë.

b) Cilido që shfrytëzon një mjet, i cili nuk operon në përputhje me licencën për transportin rrugor turistik/ të rastit të udhëtarëve ndëshkohet me masë administrative sipas shkronjës "b" të nenit 68, të ligjit 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

c) Nuk ka një tahograf dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë, ose duke përdorur një pajisje të modifikuar e aftë të ndryshojë/të ndërhyje në regjistrimet e pajisjes regjistruese dhe/ose kufizuesin e shpejtësisë ose fletën e regjistrimit të falsifikuar ose të dhëna të ngarkuara/transferuar nga tahografi dhe/ose kartës së drejtuesit të mjetit.

2. Në lidhje me dokumentet e udhëtimit:

a) Drejton mjetin pa pasur një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik dhe /ose me një defekt serioz, ndër të tjera sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit, gomat, etj., që mund të krijojnë një rrezik të menjëhershëm për sigurinë rrugore.

b) Transporton mallra që janë të ndaluara për transport ose transporton mallra të tilla në mënyrë të ndaluar ose të pa aprovuar ose pa identifikuar ato në mjet, duke rrezikuar jetët e udhëtarëve ose mjedisin.

c) Transporton udhëtarë pa pasur leje drejtimi të vlefshme ose transporti kryhet nga një subjekt transporti pa pasur një licencë /certifikatë /autorizim të vlefshëm.

d) Drejton mjetin me një dokument të drejtuesit të mjetit të falsifikuar, ose me një dokument të një drejtuesi, i cili nuk është mbajtësi i saj, ose që ka qenë mbajtur mbi bazën e një deklarimi fals dhe /ose dokument të imituar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Zhvillimit  
Ekonomik, Turizmit, Tregtisë  
dhe Sipërmarrjes  
**Milva Ekonomi**

Ministri i Transportit  
dhe Infrastrukturës  
**Sokol Dervishaj**



Lidhja 1  
 Faqja e parë  
 (Pjesa e përparme)

### Model i librit të udhëtimeve për shërbimet e rastit brenda vendit (Kapaku)

- Emri dhe simboli i bashkisë .....
- Nr. i librit .....

### Shërbimet turistik/të rastit të udhëtarëve brenda vendit

#### LIBRI I UDHËTIMIT

Për shërbimet e turistike/të rastit në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit me autobus, në përputhje me:

Kreun II.2 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik”.

Emri i transportuesit.....

Adresa: .....

.....

Numri i serisë së prodhimit të librit.....

(Vendi lëshimit të librit)

(Firma dhe vula e autoritetit që lëshon librin)

Lidhja 1  
 Faqja e parë  
 Pjesa e pasme

#### SHËNIME TË RËNDËSISHME

1. Libri i udhëtimit ju lëshohet vetëm subjekteve të licencuar për të tretë dhe me qira në transportin e udhëtarëve.

2. Libri i udhëtimit jep të drejtën e kryerjes së shërbimeve të rastit brenda vendit, që janë:

- udhëtimet me dyer të mbyllura ku i njëjti autobus do të transportojë të njëjtin grup udhëtarësh përgjatë gjithë udhëtimit dhe do t'i sjellë përsëri në pikën nga ku u nisën.

- shërbime që kryejnë udhëtimin në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimin e kthimit pa ngarkesë. Pika e nisjes është në vendin ku është vendosur operatori i transportit.

- shërbime gjatë të cilave udhëtimi në vajtje është kryer pa ngarkesë dhe gjithë udhëtarët të transportuar më parë nga i njëjti operator transporti kanë kryer udhëtimin e kthimit në pikën e nisjes.

3. Informacion rreth plotësimit të dokumentit të udhëtimit.

a) Për çdo udhëtim të kryer si një shërbim të rastit, operatori i transportit duhet të plotësojë një dokument udhëtimi në dy kopje, para nisjes së udhëtimit. Kopja e modelit të udhëtimit do të mbesë në ndërmarrje.

b) Fleta e parë e dokumentit të udhëtimit duhet të mbahet në autobus gjatë gjithë udhëtimit dhe do të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e kontrollit.

c) Gjatë shërbimeve të rastit, asnjë udhëtar nuk mund të hipë ose të zbresë gjatë udhëtimit.

d) Transportuesi është i detyruar të sigurojë që dokumenti i udhëtimit është i plotësuar në mënyrën e duhur. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet me shkronja të mëdha shtypi dhe me bojë që nuk hiqet.

4. Libri i udhëtimit mban emrin e transportuesit dhe nuk është i transferueshëm.

5. Libri i udhëtimit përdoret për 25 udhëtime të shërbimeve të rastit.

**\\Lidhja 1**







Faqja e dytë

Format A4, ngjyra e gjelbër e lehtë

**DOKUMENTI I UDHËTIMIT PËR SHËRBIME TË RASTIT BRENDA VENDIT**

Nr. i Librit: .....

Nr. i Listës së udhëtarëve. : .....

1	 <b>Targa e autobusit</b>	<b>Numri i vendeve të udhëtarëve</b> 			
2	 <b>Emri ose emri tregtar i operatorit të transportit</b>	..... ..... .....			
3	 <b>Emri i drejtuesit ose drejtuesve të automjetit</b>	1. .... 2. .... 3. ....			
<b>Lloji i shërbimit (vini një kryq në kutinë e duhur dhe shtoni informacionin plotësues</b>					
4	 <b>Udhëtime me dyer të mbyllura <input type="checkbox"/></b>	 <b>Udhëtimi i vajtjes me ngarkesë <input type="checkbox"/></b> <b>Udhëtimi i kthimit pa ngarkesë <input type="checkbox"/></b> <b>* Vendi ku kanë zbritur udhëtarët</b>			
<b>LISTA E UDHËTARËVE</b>					
NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR
1		19		37	
2		20		38	
3		21		39	
4		22		40	
5		23		41	
6		24		42	
7		25		43	
8		26		44	
9		27		45	
10		28		46	
11		29		47	
12		30		48	
13		31		49	
14		32		50	
15		33		51	
16		34		52	
17		35		53	
18		36		54	
<b>VENDI DHE DATA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT</b>			<b>FIRMA/ VULA E OPERATORIT TË TRANSPORTIT</b>		
<b>AUTORITETI KONTROLLIT</b>					

**UDHËZIM**

Nr. 8502, datë 24.10.2016

**PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E KOMITETIT  
RAJONAL TË ZHVILLIMIT TË  
TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 20, pika 4, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, "Për turizmin",

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit pranë MZHE-TTS, prefekturat e qarqeve dhe Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit për zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
**Milva Ekonomi**

**UDHËZIM**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E KOMITETIT RAJONAL TË ZHVILLIMIT  
TË TURIZMIT**

**I. Qëllimi dhe objektivat**

1.1 Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, bazuar në nenin 20, pika 4, të ligjit nr.93/2015, datë 27.7.2015 "Për turizmin".

1.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, për çështjet e turizmit.

1.3 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit ka për detyrë:

- të sigurojë një forum për të trajtuar çështjet që lidhen apo që lindin nga veprimtaritë turistike në njësitë e qeverisjes vendore;

- të sigurojë një forum për bashkëpunim, ndërmjet njësisve të qeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të tjera

të turizmit në nivel vendor, për çështjet që lindin në fushën e zhvillimit të turizmit, në zbatimin e politikës kombëtare dhe për çështje të tjera të lidhura me këtë fushë;

- të sigurojë informacion për ministrin dhe AKT-në, për çështjet e lidhura me turizmin, që krijohen në njësitë e qeverisjes vendore, sipas territorit administrativ përkatës.

II. Përbërja dhe Funksionimi i Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit

2.1 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, krijohet dhe funksionon pranë çdo prefekturë.

2.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, ka në përbërje:

- Një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për turizmin;

- Një përfaqësues nga sektori i turizmit dhe ai i kulturës, i njësisve të vetëqeverisjes vendore të përfshira në territorin e qarkut;

- Një përfaqësues nga sektori i turizmit dhe ai i kulturës, të qarkut;

- Dy përfaqësues për secilën nga shoqatat lokale, ose degët rajonale të shoqatave kombëtare, të cilët operojnë në fushën e turizmit, duke përfshirë ato të hotelarisë, të operatorëve turistikë apo të çfarëdo lloj aspekti tjetër të fushës së turizmit, të cilët operojnë në rajonin e qarkut;

- Një përfaqësues nga institucionet arsimore dhe edukuese për turizmin;

- Një përfaqësues nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura;

- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare;

- Një përfaqësues nga Agjencia e Zhvillimit të Rajoneve;

2.3 Përbërja nominale e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, caktohet me urdhër të prefektit, mbi bazën e dokumenteve të përfaqësimit të institucioneve publike, shoqatave dhe organizatave, në përbërje të Komitetit Rajonal sipas përcaktimeve të pikës 2.1.

2.4 Në rast se në territorin e qarkut nuk operojnë shoqata të tilla, prefekti njofton për pjesëmarrje dy përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë.

2.5 Në mbledhjet e Komitetit mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të tjerë të grupeve të interesit apo të institucioneve të tjera, në cilësinë e të ftuarit nga prefekti.





2.6 Në ushtrimin e funksioneve, KRZHT-ja ndihmohet nga sekretaria teknike, e cila kryhen detyrat e përcaktuara në poshtë:

- Njofton anëtarët e KRZHT-së për datën e mbledhjes dhe rendin e ditës;
- Mban procesverbalet e mbledhjeve të KRZHT-së;
- Zbardh vendimet e marra në mbledhje nga KRZHT-ja;
- Menaxhon dokumentacionin e nevojshëm për organizmin e mbledhjes;
- Iu komunikon anëtarëve të KRZHT-së dokumentacionin e disponueshëm, që do të diskutohet në mbledhjen e radhës;
- Dokumenton çdo mendimin, kërkesë apo informacion që përcjellin anëtarët;
- Kryhen çdo detyrë tjetër ndihmëse, që shkon për mirëfunksionimin e KRZHT-së.

2.7 Funksionet e sekretarisë teknike do të kryhen nga një ose disa persona të caktuar me urdhër të prefektit dhe që janë pjesë e strukturës të prefekturës.

### III. Mënyra e funksionimit

3.1 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, është një organizëm kolegjal, veprimtaria dhe funksionimi i të cilit, drejtohet nga prefekti i qarkut.

3.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, si rregull thirret nga prefekti jo më pak se 2 herë në vit, me tematikë të përcaktuar dhe të komunikuar më parë tek anëtarët nëpërmjet sekretarisë teknike.

3.3 Prefekti e thërret mbledhjen në raste të veçanta dhe për tematika që kanë afate kohore të përcaktuara, takimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit mund të zhvillohen edhe jashtë këtij rregulli.

3.4 Produkti i punës i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, janë rekomandimet që dalin nga mendimet dhe komentet e shprehura në mbledhjet e tij, të cilat pasqyrohen në formë konkluzionesh në procesverbalin e mbledhjes dhe u përcillen në formë elektronike të gjithë anëtarëve. Këto rekomandime i përcillen me shkresë zyrtare Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3.5 Me qëllim që rekomandimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit të jepen të strukturuar dhe kolegiale, është e nevojshme që aktiviteti i tij, të mos kufizohet vetëm në opinionet

dhe idetë e shprehura verbalisht në mbledhjet e rregullta, por anëtarët mund t'i parashtrijnë mendimet dhe idetë e tyre në formë të shkruar, duke ia dorëzuar paraprakisht sekretarisë teknike jo më vonë se 5 ditë pune përpara fillimit të mbledhjes.

3.6 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit informohen me shkrim, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune përpara mbledhjes, për rendin e ditës dhe çështjet që do të diskutohen. Të gjithë materialet e nevojshme duhet tu vihen në dispozicion anëtarëve të KRZHT paraprakisht nga sekretaria teknike, e cila përgatit nga një kopje për çdo pjesëmarrës, të printuar ose në formë elektronike së bashku me njoftimin për datën, orën dhe vendin e organizimit të takimit.

3.7 Procesverbali i mbledhjes u përcillet në formë elektronike, nga sekretaria teknike, të gjithë anëtarëve, jo më vonë se dita pasardhëse e takimit.

IV. Kodi i Etikës i anëtarëve të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit

4.1 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, të gjitha materialet dhe dokumentet (drafte dhe për përdorim të brendshëm) të vëna në dispozicion, nuk mund t'i bëjnë publike në medianë e shkruar dhe atë vizive.

4.2 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit duhet të shmangin tendencat për përfitime personale ose të bizneseve që ata përfaqësojnë, kur diskutohen çështje të veçanta që lidhen me vendimmarrje, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre ekonomike.

4.3 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, duhet të diskutojnë me objektivitet dhe të komunikojnë me respekt e duke krijuar mundësinë që secili të shprehë lirshëm mendimet e tij duke i argumentuar ato.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
**Milva Ekonomi**



**VENDIM**  
**Nr. 70, datë 6.12.2016**

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE  
ME GRANTE TË DREJTPËRDREJTA PËR  
NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË  
MESME**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

Znj. Milva Ekonomi	kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtar;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar;
Z. Petrit Baku	anëtar;
Z. Gramoz Hoxha	anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 6.12.2016, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

**I. PROÇEDURA**

1. Me shkresën nr. 76 datë 2.12.2016, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) masën e sipërpërmendur.

**II. PËRSHKRIMI I MASËS**

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është përmirësimi i ekonomisë në Shqipëri përmes mbështetjes financiare me grante për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 3.8.2016 “Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”

c) Dhënësi i Ndhmës

4. Dhënës i ndihmës është Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER).

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndhma do të jepet në formën e granteve direkte.

d) Buxheti dhe kohëzgjatja e ndihmës

6. Vlëra gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve e vogla dhe të mesme është 200 000 000 lekë. Burimet financiare për financimin e ndërmarrjeve mund të jenë:

a) kontribut nga buxheti i shtetit;

b) të ardhurat e veta, nga mjete dhe/ose burime të tjera financiare, nëpërmjet:

i. kontributit nga programe të ndihmës së huaj, sipas marrëveshjeve me partnerët e huaj për zhvillim dhe integrim;

ii. kostove të menaxhimit, për programe apo projekte që ata zhvillojnë, me disa përfitues;

iii. burime të tjera të ligjshme, si donacione etj.

Masa do të zbatohet për periudhën 2016-2017.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Masa ka për qëllim të shoqërojë investimet infrastrukturore, vendore dhe rajonale, me masa nxitëse ndaj aktiviteteve ekonomike brenda dhe rreth zonës ku do të investohet, sipas objektivave të politikës së zhvillimit rajonal; të nxitë krijimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale me partnerë publikë dhe privatë; të financojë projektet zhvillimore të cilat nxitin zhvillimin e ekonomisë rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

8. Ndhma në formën e grantit të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme parashikohet të jepet për 51-100 ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

ë) Aktivitet të cilat përfitojnë ndihmë shtetërore

9. Një ndërmarrje e vogël dhe e mesme do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- është ndërmarrje e klasifikuar si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar;

- ka selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të rajonit;

- ka paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe tatimor;

- është në gjendje të financojë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit.

**III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETËRORE**

a) Ndhmë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërbortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e



*detyrimeve të ndërmarrta nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”*

11. Masa e njoftuar mundëson përfitimin e burimeve financiare vetëm për një numër të caktuar ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme me një aktivitet të caktuar ekonomik. Autoriteti publik (AZHER) do t'i ofrojë këtyre ndërmarrjeve burime financiare me kushte më të mira se sa ato që ofrohen në treg. Si rrjedhim, skema ofron një avantazh/përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre. Produktet dhe shërbimet e ndërmarrjeve të përzgjedhura mund të jenë pjesë e tregut të përbashkët rajonal, duke përmirësuar pozitën konkurruese të tyre dhe më pas ndikuar në tregtinë rajonale.

12. Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që i bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. VKM nr. 580, datë 3.8.2016 pika 5 parashikon se:

“Për skemën e mbështetjes financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) nëpërmjet bashkëfinancimit se në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar, aplikanti përfiton deri në 50% të vlerës totale të investimit, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë/projekti”.

14. Sa më lart skema e ndihmës ka efekt nxitës, duke qenë se është një burim i konsiderueshëm kapitali për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që në fazën e hershme të krijimit dhe fillimit të funksionimit të biznesit. Si e tillë, skema e njoftuar është në përputhje me nenin 13, shkronja c) “Ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke qenë se lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja ç, 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

#### VENDOSI :

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore me grante të drejtpërdrejta për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.580, datë 3.8.2016, “Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”, mbështetur në nenin 13, germa “c” e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) bazuar në nenin 20, pika 1 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Milva Ekonomi**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë